



Datë: 09.06.2025
Numër Protokolli: 5362/2025

A.nr.745/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi, kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.745/2025, të datës 28.04.2025, të parashtruar nga ankuesja V.S, të cilën me autorizim e përfaqëson avokat Agim Rexhaj nga Ferizaj, kundër organit të punësimit Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike ‘*kundërshtim i masës disiplinore*’, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të datës 09.06.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.745/2025, e datës 28.04.2025, e parashtruar nga ankuesja V.S.

II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër protokolli 593, i datës 20.03.2025, i Komisionit Disiplinor i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Nëpunësja civile V.S (*referuar tutje ankuesja*), më datë 23.04.2025, përmes postës ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, (e pranuar më datë 28.04.2025, e regjistruar nën shenjë A.nr.745/2025) kundër Vendimit me numër protokolli 593, të datës 20.03.2025, të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*me tej Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 07.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Agjencia e Punësimit e Republikës së Kosovës (tutje APRK), ndërsa, kjo e fundit, më datë 14.05.2025, ka përcjell përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2802/2025, të datës 28.04.2025, e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizimin e datës 04.04.2025; Vendimin me numër

protokolli 593, të datës 20.03.2025 të Komisionit Disiplinor të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës; Kopjen e ID-së së ankueses; Zarfën e datës 23.04.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë, të datës 07.05.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 14.05.2025; Akt emërimit e datës 28.12.2017; Emailin e datës 23.12.2024 nga Drejtori i Përgjithshëm i APRK për anëtarët e Komisionit Disiplinor; Emailin e datës 02.12.2024 nga Zyrtari Përgjegjës për Sinjalizim për Drejtorin e Përgjithshëm të APRK; Dëftesë për pranimin e vendimit datës 25.03.2025; Procesverbalin e datës 08.01.2025 të Komisionit Disiplinor për intervistim të ankueses; Procesverbalin e datës 27.01.2025 të Komisionit Disiplinor për intervistim të N.G; Procesverbalin e datës 08.01.2025 të Komisionit Disiplinor për intervistim të L.H, M.B, V.B, S.B; Procesverbalin e datës 08.01.2025 të Komisionit Disiplinor për intervistim përfaqësuesin e kompanisë Internacional Security Association SH.P.K; Procesverbalin e datës 05.02.2025 të Komisionit Disiplinor për intervistim të B.Z; Procesverbalin e datës 31.01.2025 të Komisionit Disiplinor për intervistim të A.L; Procesverbal mbi seancën e shqyrtimit të provave nga Komisioni Disiplinor i datës 22.01.2025, 31.01.2025, 26.12.2024, 22.01.2025; Procesverbalin mbi seancën e shqyrtimit të provave dhe marrjen e vendimeve në Komisionin Disiplinor të datës 19 dhe 20 mars 2025; Njoftimin për iniciimin e procedurës disiplinore për ankuesen datë 03.01.2025; Njoftimin e datës 13.02.2025 nga L.B për ankuesen; Kontratën Publike Kornizë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421 dhe Aneksi 1; Raportin e prezencës në punë për datë 22.07.2024 në Zyrën e Punësimit në Ferizaj; Procesverbalin e Komisionit Disiplinor i datës 21.02.2025; Kërkesën e datës 17.11.2023 nga Udhëheqësi i Zyrës së Punësimit në Ferizaj; Emailin e datës 27.01.2025 nga L.B për N.G; Libri Raporti Ditari i Punës nga Internacional Security Associates SH.P.K; Emailin e datës 24.09.2024 nga N.G për I.D; Vendimin me numër protokolli 487 të datës 22.07.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të pastrimit të objektit të Zyrës së Punësimit në Ferizaj; Raportin mbi shërbimin e pastrimit të objektit i datës 22.07.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të pastrimit dhe mirëmbajtjes; Urdhër pagesë i datës 20.12.2024; Raportin mbi shërbimin e sigurimit të objektit të Zyrës së Punësimit në Ferizaj i datës 22.11.2024; Vendimin e datës 16.09.2024 për procedurat dhe përgjegjësit e pranimin të mallrave dhe shërbimeve në Zyrën e Punësimit dhe Qendrat e Aftësimit Profesional; Urdhër pagës e datës 20.11.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.09.2024 deri 16.10.2024; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.09.2024 deri 16.10.2024; Urdhër pagesë e datës 08.10.2024; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.08.2024 deri 16.09.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.08.2024 deri 16.09.2024; Urdhër për pagese e datës 10.09.2024; Vendimin me numër protokolli 540 i datës 19.08.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.07.2024 deri 16.08.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.07.2024 deri 16.08.2024; Urdhër për pagës i datës 30.07.2024; Vendimin me numër protokolli 486 i datës 22.07.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.06.2024 deri 16.07.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.06.2024 deri 16.07.2024; Urdhër për pagesë e datës 27.06.2024; Vendimin me numër protokolli 421 i datës 18.06.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.05.2024 deri 16.06.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.05.2024 deri 16.06.2024; Urdhër për pagës i datës 24.05.2024; Vendimin me numër protokolli 341 i datës 20.05.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.04.2024 deri 16.05.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.04.2024 deri 16.05.2024; Urdhër për pagës e datës 29.04.2024; Vendimin me numër protokolli 245 i datës 22.04.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-

Ferizajt për periudhën 17.03.2024 deri 16.04.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.03.2024 deri 16.04.2024; Urdhër për pagesë e datës 03.04.2024; Vendimin me numër protokolli 488 i datës 18.03.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.02.2024 deri 16.03.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.02.2024 deri 16.03.2024; Urdhër për pagesë i datës 06.03.2024; Vendimin me numër protokolli 111 i datës 21.25.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.01.2024 deri 16.02.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.01.2024 deri 16.02.2024; Urdhër për pagesë e datës 12.02.2024; Vendimin me numër protokolli 49 i datës 22.01.2024 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.12.2023 deri 16.01.2024; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.12.2023 deri 16.01.2024; Urdhër për pagesë i datës 26.12.2023; Vendimin me numër protokolli 731 i datës 18.12.2023 për emërimin e komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit për ZP Ferizaj; Raporti mbi shërbimin e sigurimit të objektit të ZP-Ferizajt për periudhën 17.11.2023 deri 16.12.2023; Raportin mujor për kryerjen e shërbimeve të sigurimit fizik për periudhën 17.11.2023 deri 16.12.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur së ankesa është e pabazuar, **sepse:**

Nga administrimi i provave të lëndës rrjedhë së ankuesja sipas Akt Emërimit me numër protokolli 119 të datës 28.12.2017, është e punësuar në pozitën Zyrtar për Shërbime të Punësimit, në Zyrën e Punësimit në Ferizaj, në kuadër të APRK-së.

Tutje, Zyrtari përgjegjësi për sinjalizim në kuadër të APRK-së, përmes emailit të datës 02.12.2024, ka paraqitur tek Drejtori i Përgjithshëm i APRK-së, rastin e sinjalizimit përkitazi me sigurimin fizik të objekteve të APRK-së, ndërsa, Drejtori i Përgjithshëm i APRK-së, më datë 23.12.2024, ka proceduar rastin në Komisionin Disiplinor të APRK-së.

Komisioni Disiplinor i APRK-së, më Vendimin me numër protokolli 593, të datës 20.03.2025, ka shpall ankuesen përgjegjëse për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 56, paragrafi 4, pika 4.5 “*veprime ose mos veprime që kanë shkaktuar pasoja*”, dhe të njëjtës i ka shqiptuar masën disiplinore “*Ndalimi i pagës bazë në vlerën njëzet e pesë përqind (25%) për periudhën katër (4) muaj*”.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundërshton Vendimin me numër protokolli 593, të datës 20.03.2025, të Komisionit Disiplinor të APRK, të cilin sipas librit të pranimi e ka pranuar më datë 25.03.2025, duke pretenduar së nuk ka pasur asnjë obligim për zbatimin e kontratës së sigurimit fizik, dhe dokumenti është plotësuar siç ka ardhur nga Udhëheqësi i Zyrës. Komisioni Disiplinor ka bërë në mënyrë të gabueshëm deklaratat e ankueses ngase nuk janë marr për bazë asnjë rrethana lehtësuese, duke mos shqyrtuar faktin se ndaj ankueses nuk është shqiptuar më parë masë disiplinore, ngase ankuesja nuk ka pasur qasje dhe po ashtu nuk ka qenë e njoftuar për ndërrim të orarit të sigurimit të objektit. Kërkon të aprovohet ankesa dhe të anulohet vendimi i kundërshtuar me ankesë.

Ndërsa, në kuptim të shqyrtimit të pretendimeve të ankueses, Kolegji i Këshillit analizoj dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë që rregullojnë disiplinën dhe procedurën disiplinore të nëpunësve civil, me theks të veçantë:

- Nenin 55 paragrafi 1: “Nëpunësja/i civil mban përgjegjësi disiplinore për shkelje të detyrave dhe përgjegjësi, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim”.

- Nenin 56, paragrafi 1 dhe 4: “Shkeljet e detyrave dhe përgjegjësi të punës mund të jenë: 1.1. shkelje të lehta; 1.2. shkelje të rënda. Shkelje të rënda konsiderohen: 4.1. mospërbushja e detyrave të punës; 4.2. neglizhencë e vazhdueshme në përbushje të detyrave të punës; 4.3. mosrespektimi i afateve të caktuara për përbushjen e detyrave të punës; 4.4. moszbatimi i dispozitave ligjore për përbushjen e detyrave funksionale; 4.5. veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja; 4.6. shkelja e rregullave të përcaktuara në kodin e etikës; 4.7. sjellje e papërshtatshme që dëmton reputacionin e shërbimit civil; 4.8. vënia në lajthitje e organit publik përmes dhënies së informatave të gabuara ose fshehja e të dhënave zyrtare kur kërkohen për qëllime zyrtare; 4.9. përfitimi apo ofrimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale që ndodhin për shkak të detyrës; 4.10. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vazhdueshme për tri (3) ose më shumë ditë pune; 4.11. përsëritja e shkeljeve të lehta disiplinore dy (2) apo më shumë herë; 4.12. moslajmërimi i shkeljeve të rënda që lidhet me detyrat e punës nga nëpunësja/i civil; dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 4.14. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit dhe dokumenteve të klasifikuara; 4.15. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera narkotike të ndaluara; 4.16. përdorimi i alkoolit në vend të punës ose ardhja e/i dehur në punë; 4.17. keqpërdorimi i detyrës zyrtare lidhur me procedurën e rekrutimit nga anëtarët/ët e komisionit të rekrutimit që janë shërbyes civil; 4.18. ngacmimet në vendin e punës apo gjatë ushtrimit të detyrës, që cenojnë integritetin moral dhe fizik, si dhe ato seksuale; 4.19. diskriminimi mbi baza gjinore, racore dhe të tjera, sipas Ligjit përkatës Kundër Diskriminimit; 4.20. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi”. -Nenit 57 paragrafi 2 : “ Masat disiplinore, të cilat mund të shqiptohen ndaj nëpunëses/it civil për shkelje të rënda janë: 2.1. ndalimi nga njëzet për qind (20%) deri në pesëdhjetë (50%) e pagës bazë për një periudhë deri në gjashtë (6) muaj; 2.2. ndalimi i avancimit/emërimit në kategori më të lartë, për një periudhë nga një (1) deri në pesë (5) vite; 2.3. transferimi në pozitë të ngjashme në klasë dhe kategori të njëjtë; 2.4. ulja në pozitë; 2.5. pezullimi nga pozita pa pagesë deri në gjashtë (6) muaj; 2.6. pezullimi nga pozita me ndalim deri në pesëdhjetë për qind (50%) të pagës bazë, deri në një (1) vit; 2.7. largimi nga shërbimi civil”. -Nenin 58, paragrafi 2 : “Masat disiplinore për shkeljet e rënda shqiptohen nga komisioni disiplinor”.

Referuar kuadrit ligjor si me sipër, Kolegji ka analizuar aktin e kundërshtuar më ankesë në ndërlidhje me provat materiale të çështjes dhe si rrjedhojë vlerëson së Komisioni Disiplinor ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, si dhe ka aplikuar drejtë ligjin material në çështjen disiplinore të ankueses, duke argumentuar saktë përgjegjësinë disiplinore të ankueses si dhe ka zbatuar masë të drejtë disiplinore në raport me shkeljen disiplinore të ndodhur.

Në këtë kontekst, Kolegji nga shqyrtimi i provave materiale ka gjetur së Agjencia Qendrore e Prokurimit, më datë 14.11.2023, ka lidhur Kontratë Publike Kornizë UA/2016-23-9156-2-1-1/C421, për shërbimet e sigurimit fizik të objekteve të APRK-së, ku sipas aneksis 1 të kësaj kontrate (Specifikimet Teknike të Detyrueshme) është përcaktuar orari i sigurimit fizik në kuadër të Zyrave të Punësimi dhe Qendrave të APRK-së, ashtu që, për Zyrën e Punësimi në Ferizaj, është përcaktuar orari në intervalin kohor 08:00-16:00 dhe atë 5 ditë, (duke nënkuptuar ditët zyrtare të punës), kurse, për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit në Zyrën e Punësimi në Ferizaj, ishte themeluar Komisioni had hoc, ku ankuesja ka qenë pjesë e këtij komisioni dhe atë sipas Vendimit me numër protokolli 731 të datës 18.12.2023, Vendimit me numër protokolli 49 të datës 22.01.2024, Vendimit me numër protokolli 111 të datës 21.02.2024, Vendimit me numër protokolli 188 të datës 18.03.2024, Vendimit me numër protokolli 245 të datës 22.04.2024, Vendimit me numër protokolli

341 të datës 20.05.2024, Vendimit me numër protokolli 486 të datës 22.07.2024, Vendimit me numër protokolli 540 të datës 19.08.2024.

Rrjedhimisht, nga analizim i vendimeve për themelim të komisionit ad hoc për pranimin e shërbimit të sigurimit fizik të objektit në Zyrën e Punësimit në Ferizaj, Komision ka qenë përgjegjës që të pranoj shërbimin sipas plotësimit të kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në dispozita ligjore dhe sipas kërkesës për furnizim dhe së i njëjti obligohej të posedonte si dhe të prezantoj-procesin fletë-pagesën e nënshkruar lidhur me pranimin e furnizimit me rastin e sjelljes së faturave për pagesë. Në fakt, sipas librave të evidentimit të kompanisë së sigurimit për periudhën **18.11.2023 deri 15.11.2024**, siguri fizik i zyrës regjionale në Ferizaj, ishte bërë nga ora 16:00 deri në ora 24:00, ndërsa, Komisioni Ad hoc kishte pranuar këto shërbim si të rregullta, përmes raportit të datës 18.12.2023 për periudhën 17.11.2023, deri më datë 16.12.2023, raportit të datës 22.01.2024 ,për periudhën 17.12.2023 deri më datë 16.01.2024, raportit të datës 18.03.2024, për periudhën 17.02.2024 deri 16.03.2022, raportit të datës 22.04.2024, për periudhën 17.03.2024 deri më datë 16.04.2024, raportit të datës 20.05.2024, për periudhën 17.04.2024 deri 16.05.2024, raportit të datës 22.07.2024, për periudhën kohore 17.06.2024 deri më datë 16.07.2024, raportit të datës 19.08.2024, për periudhën kohore 17.07.2024 deri 16.08.2024.

Rrjedhimisht në vazhden e shqyrtimit të provave të lëndës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar së të gjithë anëtarët e Komisionit ad hoc për pranim të shërbimit të sigurimit fizik në Zyrën e Punësimit në Ferizaj, si dhe dëshmitarja A.L kanë pohuar pranë Komisionit Disiplinor së asnjëherë nuk kanë pa punëtor të kompanisë për siguri fizik gjatë orarit të punës 8:00 deri 16:00, mirëpo, anëtarët e komisionit ad hoc nënshkrimin e raporteve të pranimin të shërbimit në fjalë i arsyetojnë së ketë e kishin bërë në baza të mirëkuptimit me udhëheqësin e Zyrës së Punësimit në Ferizaj. Gjegjësisht, ankuesja në seancën dëgjimore të datës 08.01.2025, ka deklaruar se: *këtë veprim e ka bërë me mirëkuptim dhe mirëbesim duke u bazuar në përgjegjësin e udhëheqësit Naim Gashi obligimet edhe sinqeritetin e tij...në pyetjen e Komisionit Disiplinor se: sipas raporteve të muajve dhjetor 2023, janar 2024, shkurt 2024, mars 2024, prill 2024, qershor 2024 dhe korrik 2024, ju keni pranuar shërbimin për siguri fizik për Zyrën e Punës në Ferizaj. A janë të nënshkruar këto raport nga ju?, ankuesja është përgjigjur: të gjitha raportet e prezantuara nga komisioni janë të nënshkruara nga unë, pyetja e komisionit se: pse dhe në çfarë rrethane keni nënshkruara pranimin e shërbimit në fjalë, në raportin e Zyrës së Punësimit dhe në raportin e kompanisë? ankuesja ka deklaruar: Gjithmonë në zyre kam qenë dhe ka ardh ma kanë sjell kryesuesi i komisionit raportet për nënshkrim, unë kam nënshkruar gjithmonë duke u bazuar në mirëbesim, mirëkuptim, ndërgjegje të kryesuesit të këtij komisioni si dhe udhëheqësit të zyrës së punësimit Naim Gashi...pyetja e komisionit: Për periudhat e lartcekura në të cilat keni nënshkruar raportet e pranimin të shërbimit, a ka pasur personel të sigurimit në objektin e Zyrës së Punësimit në Ferizaj?, ankuesja ka deklaruar: nga ora 08:00-16:00 unë nuk kam parë personel fizik, nëse na është thënë nga drejtor Naim Gashi se sigurimit fizik fillon prej orës 17:00 deri në orën 24:00. Po ashtu unë nuk kam pranuar asnjëherë kontratën e sigurimit në email apo fizikisht nga udhëheqësi Naim Gashi.*

Për me tepër, Komisioni Disiplinor më datë 31.01.2025, në cilësinë e dëshmitarit ka dëgjuar N. Jupaj përfaqësi i International Security Association SH.P.K, i cili në seancën dëgjimore kishte pohuar: se më datë 17.11.2023 më ka kërkuar Naim Gashi Udhëheqës i Zyrës së Punës në Ferizaj që a është e mundur të më sillni sigurimin fizik pas orës 16:00 sepse jemi duke e parë më të arsyeshëm që me qenë siguri pas orës 16:00 deri në ora 24:00 dhe unë i kam kërkuar që më të dërgoj një shkresë zyrtare...ndërsa ndër të tjera ka deklaruar se ka përmbushur kontratën mirëpo nëse i referohemi librit të raportit të punës nga kompani Internacionale Security Association SH.P.K, rezulton se nga data 17.11.2023 deri më datë 15.11.2024 siguri fizik është bërë nga ora 17:00 deri në orën 24:00.

Andaj, bazuar në të gjeturat dhe konstatimet si më sipër, e në mbështetje të nenit 88 dhe 89 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet: “**Neni 88 1.** Organi publik, për të përcaktuar gjendjen e fakteve dhe rrethanat e ndërlidhura me çështjen, mund të përdorë çdo mjet prove të paraparë nga ligji për procedurën kontestimore. 2. Faktet tashmë të njohura për organin publik, faktet e njohura botërisht apo faktet e prezumuara me ligj, nuk kanë nevojë të provohen. **Neni 89** Organi publik vlerëson, sipas bindjes së tij, se cilat fakte do të konsiderohen të provuara, bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veçmas dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ”, Kolegji i Këshillit pas analizimit të provave materiale të parashtruara nga palët në procedurë erdhi në përfundimin se në veprimet e ankueses manifestohen të gjitha elementet e shkeljes së rëndë disiplinore “veprimet apo mosveprimet që kanë shkaktuar pasoja” dhe së masa disiplinore e shqiptuar ndaj ankueses është në proporcion me shkeljen e konstatuar, dhe si rrjedhojë, rezulton së akti i kundërshtuar me ankesë është akt i ligjshëm dhe i nxjerr mbi gjendje të fakteve të vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë si dhe me zbatim të drejtë të ligjit material.

Kështu që, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1, nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, rrjedhimisht e refuzoi ankesën si të pabazuar dhe e la në fuqi si të ligjshëm Vendimin me numër protokolli 593, të datës 20.03.2025, të Komisionit Disiplinor, të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda: A.nr.745/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokat Agim Rexhaj;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në APRK dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.